

NDIHMË EKONOMIKE

Kur je e ekspozuar ndaj kërcënimeve
dhe dhunës në marrëdhëniet me të afërm

Je e ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe/ose dhunës nga një person i afërm por nuk largohesh për shkak të mungesës së mundësive ekonomike?

Kjo broshurë të jep informacion se si mund të aplikosh për ndihmë ekonomike për të mund të krijuar kushte për të jetuar një jetë pa kërcënime dhe/ose dhunë.

Informacioni i drejtohet:

- ty që je e ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe/ose dhunës nga persona të afërm dhe je në nevojë ndihme ekonomike
- ty që punon në një strehë për gra ose një strehë tjetër të fshehur dhe që je në kontakt me gra që janë të ekspozuara ndaj dhunës
- ty që punon në një autoritet publik dhe që ke nevojë për informacion që mund të gjendet me lehtësi mbi ligjet dhe rregullat lidhur me ndihmën ekonomike në rast dhune në marrëdhëniet me të afërm

Dhunë dhe abuzim ndaj grave në marrëdhëniet me të afërm

Në ligjin për shërbimin social parashikohet që shërbimi social “duhet të ketë parasysh veçanërisht që gratë të cilat janë ose kanë qenë të ekspozuara ndaj dhunës ose abuzimeve të tjera nga persona të afërm mund të kenë nevojë për mbështetje dhe ndihmë për të ndryshuar situatën e tyre”. Edhe fëmijëve që kanë qenë dëshmitarë të dhunës apo abuzimeve të tjera nga ose kundrejt personave të afërm duhet t’u ofrohet ajo mbështetje dhe ndihmë për të cilën ato kanë nevojë (5 kap 11 § Ligji për shërbimin social).

Ndihma ekonomike

Të drejtë për ndihmë ekonomike ka ai person që nuk ka mundësi të përballojë jetesën. Këtij personi duhet t’i garantohet në bazë të ligjit një nivel i arsyeshëm jetese dhe ndihma do të jetë e tillë që ajo të rrisë mundësitë e këtij personi për të jetuar një jetë të pavarur. E drejta për ndihmë i referohet “përballimit të jetesës” (ndihmës për përballimin e jetesës) dhe “të jetuarit në përgjithësi” (4 kap 1 § Ligji për shërbimin social). Këtu mund të futen për shembull shpenzimet për banim, ushqim, rroba, kujdes shëndetësor ose medikamente. Ndihma për përballimin e jetesës llogaritet në bazë një norme kombëtare, një nivel që është i njëjtë në të gjithë vendin, dhe shpenzimet e arsyeshme jashtë normës kombëtare (Bordi Social, 2018).

Ligji thotë që nëse në një rast të caktuar ka arsye të veçanta, shërbimi social mund t’i llogarisë këto shpenzime në një nivel më të lartë (4 kap 3 § Ligji për shërbimin social). Arsye të veçanta mund të jenë që ti je ekspozuar ndaj dhunës, kërcënimeve dhe/ose abuzimeve të tjera në marrëdhëniet me të afërm (SOSFS 2013:1, 2014:4).

Arsye të veçanta - nivel më i lartë

Shërbimi social mund ta llogarisë ndihmën ekonomike në një nivel më të lartë nëse ti je ekspozuar ndaj dhunës apo abuzimeve të tjera nga një i afërm dhe ti për këtë arsye ke shpenzime të përkohshme të larta si për shembull për:

- ushqime, rroba dhe këpucë ose telefon.

Gjithashtu ti mund të përfitosh ndihmë edhe me:

- nevoja urgjente
- shpenzime më të larta për banim
- blerje të sendeve që ke lënë në shtëpi dhe që nuk ke mundësi t'i marrësh
- blerje të pajisjeve të nevojshme shtëpiake nëse ti duhet të transferohesh në një banesë tjetër
- lehtësimin e vendosjes në një vend tjetër

Zakonisht kur aplikon për ndihmë ekonomike, llogariten shpeshherë të ardhurat e përbashkëta që ti ke së bashku me partnerin tënd. Megjithatë shërbimin social duhet të bëjë përjashtime nga ky parim nëse ti je ekspozuar ndaj dhunës ose abuzimeve nga partneri jot (SOSFS 2013:1).

Cilës komunë duhet t'i drejtohesh?

Në radhë të parë duhet t'i drejtohesh komunës ku banon por nëse ti ndodhesh në një komunë tjetër, ke të drejtë të aplikosh për ndihmë urgjente tek ajo komunë.

Azilkërkueset

Nëse ti gjatë kohës së azilit ekspozohesh ndaj dhunës ose abuzimeve të tjera nga një i afërm, komuna ku ti banon ka përgjegjësinë kryesore që ty të të jepet ajo mbështetje dhe ndihmë për të cilën ke nevojë. Komuna do t'a shqyrtojë aplikimin tënd për ndihmë, në ato raste kur ti aplikon për ato ndihma që nuk mbulohen nga LMA (Bordi Social, 2016, ligji për pritjen e azilkërkuesve, etj.).

Si mund të aplikosh?

Ti ke gjithmonë të drejtë të aplikosh për ndihmë dhe që aplikimi të shqyrtohet. Shqyrtuesi jot në komunë merr vendimin lidhur me ndihmën ekonomike pas një shqyrtimi të nevojës individuale ku faktorët që merren parasysh janë nevojat dhe kushtet e tua. Theksoje në aplikimin tënd që ti je ekspozuar ndaj dhunës në marrëdhënie me të afërm dhe se pse ti ke nevojë për ndihmë ekonomike të një niveli më të lartë. Aplikimi duhet të bëhet me shkrim. Kërko ndihmë nga personat që e njohin situatën tënde ose nga një strehë për gratë.

Vendimi nga shërbimi social

Ti ke gjithmonë të drejtë që vendimi i shërbimit social të jetë me shkrim. Nëse ti nuk je e kënaqur me vendimin, mund t'a apelojë atë.

Apelimi duhet bërë me shkrim dhe duhet bërë brenda 3 javësh nga data që ti ke marrë vendimin. Lexoje vendimin me kujdes, shkruaj me fjalët e tua se pse e kundërshton arsyetimin e vendimit dhe dërgoje apelimin brenda afatit. Shkruaj atë që dëshiron të thuash dhe përshkruaje situatën tënde në mënyrë sa më të detajuar të jetë e mundur. Përshkruaj ndjenjat dhe eksperiencat e tua në mënyrë të qartë dhe mundësisht jep edhe shembuj.

Edhe gjatë këtij procesi mund të kërkojë ndihmë nëse ke nevojë!

DËSHIRON TË DISH MË SHUMË DHE TË MARRËSH NDIHMË PRAKTIKE?

Streha për gratë ALVA përhap informacion mbi të drejtat e grave në përputhje me ligjin për shërbimin social kur ato janë të ekzpozuar ndaj kërcënimeve dhe dhunës në marrëdhëniet me të afërm. Ne dëshirojmë t'i forcojmë gratë lidhur me mundësitë e tyre që ato të ndikojnë situatën e tyre. Ne gjithashtu u japim këshilla dhe mbështetje personave të tjerë të prekur.

Mos hezito të na kontaktosh!

Ne mirëpresim si personat privatë ashtu edhe autoritetet publike të kontaktojnë strehën për gra ALVA për më tepër informacion ose këshillim dhe mbështetje:

Tel: +46 303 33 22 40

Tel: +46 705 08 44 31

info@alvakvinnojour.se

www.alvakvinnojour.se



GENOMFÖRS MED BIDRAG FRÅN
JÄMSTÄLLDHETSMYNDIGHETEN